

## NJOFTIM

Pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, për llogari të Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor, është paraqitur për shqyrtim çështja Nr.35 Regj. Themeltar, Datë 19.06.2023 Regjistrimi, me:

**PADITËS:** Lefter Maliqi.

**TË PADITUR:** - Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve, pranë Komisionit Qendror Zgjedhor.  
- Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

**PERSON I INTERESUAR:** Subjekti Zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”.

**OBJEKTI:** Shfuqizimin/anullimin dhe/ose konstatimin e pavlefshmërisë absolute tërësore dhe/ose të pjesshme të Vendimit nr.178, datë 13.06.2023 të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve (KAS) në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, duke vendosur si më poshtë:

1. Ndryshimin e vendimit nr. 101, datë 16.06.2023 të ZAZ-së nr. 64, bashkia Kuçovë, qarku Berat “Për miratimin e tabelës përmbledhëse të rezultateve për zgjedhjen e kryetarit të bashkisë Kuçovë” dhe duke u shpallur unë Lefter Maliqi si fitues i zgjedhjeve vendore në Bashkinë Kuçovë për mandatin e kryetarit të kësaj Bashkie.
2. Rinumërim dhe rivlerësim i votave për ZAZ-në nr. 64, të gjitha QV-të, duke përfshirë në të rezultatin e dalë nga rinumërimi dhe rivlerësimi i votave për QV-të e listuara në tabelë.
3. Pavlefshmëri e vendimit nr. 101, datë 16.05.2023 “Për miratimin e tabelës përmbledhëse të rezultateve për zgjedhjen e kryetarit të bashkisë Kuçovë”.
4. Konstatim i pavlefshmërisë së vendimit të KQZ-së ku është emëruar sekretari i KZAZ-së nr. 64 Kuçovë, shtetasi Romeo Arizi.
5. Pavlefshmëri e vendimit të KZAZ-së nr. 64 Kuçovë, qarku Berat, për shtyrjen e numërimit të votës, nga ora 10:00 deri në orën 12:30.
6. Pavlefshmëri e pjesëshme e fletës së votimit Kandidatët për Kryetar Bashkie për Bashkinë Kuçovë, në pikën ku është shënuar kandidati për bashkinë Kuçovë, qarku Berat, Kreshnik Hajdari .
7. Pavlefshmëri e veprimit juridik, formulari i dekriminalizimit, në emër të Kreshnik Hajdarit dorëzuar pranë KQZ referuar ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

Më datë **20.06.2023** u hodh shorti publik për përcaktimin e përbërjes së Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor dhe, sipas tij, trupi gjykues përbëhet nga gjyqtarët:

- 1. Marsela Dervishi (Relatore);**
- 2. Esmeralda Xhili (Anëtare);**
- 3. Manjola Xhaxho (Anëtare);**
- 4. Edlira Petri (Anëtare);**
- 5. Blerona Hasa (Anëtare).**

Me Urdhër datë 22.06.2023 “Për caktimin e seancës gjyqësore” të Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor është caktuar data **23.06.2023, ora 09:00**, për zhvillimin e seancës gjyqësore pranë sallës “Amfiteatri”, në selinë e Këshillit të Lartë Gjyqësor, me adresë: **Godina Poli i Drejtësisë, Rr. “Ana Komnena”, Tiranë.**

**Tiranë, më 22.06.2023**

**Gjykata Administrative e Apelit Tiranë**